

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 5078 REP.  
NR. 334 KOL.



**KONTRATË DHURIMI KUOTASH**  
**(PER TRANSFERIMIN E KUOTAVE TE KAPITALIT THEMELTAR)**

Sot me date 27.07.2005 (dymije e pese), perpara meje Noteres Elsa Sina, me seli ne Tirane, ne Rr. "Mihal Grameno", u paraqiten personalisht palet e kesaj kontrate dhurimi kuotash kapitali, te cilat kerkuan hartimin e kontrates si me poshte:

**Palet e Kontrates:**

1. **z.Julien ROCHE**, shtetas francez, i biri i Mariusit, i datelindjes 1954, banues ne Vila Nr.11, Plazh, Durres, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr. 91AE75972, Ortak i Shoqerise " ADA KONSTRUKSION" Sh.p.k., person juridik i rregjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatës së Shkalles se Pare Tiranë, me vendimin nr. 26815, datë 13.10.2001,

( ne vijim " Dhuruesi"); dhe

2. **z. Gjergj SKENDAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Marselit, i datelindjes 29.08.1981, lindur dhe banues ne Tiranë, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, Ortak i Shoqerise " ADA KONSTRUKSION" Sh.p.k., person juridik i rregjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatës së Shkalles se Pare Tiranë, me vendimin nr. 26815, datë 13.10.2001, i identifikuar nga Pasaporta. Nr. 21011411 ( ne vijim " Pranuesi i Dhurimit );

**Baza Juridike e Kontrates**

Baza Juridike e kesaj kontrate eshte legjislacioni shqiptar, perkatesisht ligji Nr.7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ", neni 45 e vijim, dhe Kodi Civil Shqiptar, neni 761 e vijim .

**Objekti i Kontrates**

Objekt i kesaj Kontrate Dhurimi eshte dhurimi i kuotave te kapitalit themeltar, te cilat zoterohen nga Dhuruesi ne Shoqerine "ADA KONSTRUKSION" sh.p.k, person juridik i rregjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me vendimin nr.26815, date 13.10.2001, me Ortake te saj, z.Julien Roche, zoterues i 45%( dyzet e peseperqind) te kuotave te kapitalit themeltar, me vlere 180.000 leke, z.Gjergj Skendaj, zoterues i 45%( dyzet e peseperqind) te kuotave te kapitalit themeltar, me vlere 180.000 leke dhe z. Faruk Kaba, zoterues i 10%( dhjetepaqind) te kuotave te kapitalit

J

themeltar, me vlere 40.000 leke, me seli ne ne Rr.Dervish Hima, " ADA TOWER", Tirane.

Ortaku i Shoqerise ( Dhuruesi ), z. Julien Roche, i dhuron kuotat e kapitalit themeltar qe zoteron ne Shoqeri, Pranuesit te Dhurimit, njekohesisht edhe Ortak i Shoqerise, z.Gjergj Skendaj, duke i kaluar atij plotesisht te drejten e pronesise mbi kuotat perkatese te kapitalit themeltar te " ADA KONSTRUKSION"sh.p.k.

### **Kushtet e Kontrates**

Dhuruesi i dhuron Pranuesit te Dhurimit pa barre, pa kusht dhe pa shperblim, pjesen perkatese te kuotave te kapitalit themeltar, te zoteruar prej tij ne Shoqeri; konkretisht z. Julien Roche dhuron 45%( dyzetepesepersqind) te kuotave te kapitalit themeltar, te zoteruara prej tij, duke i kaluar Pranuesit te Dhurimit, z. Gjergj Skendaj, te drejten e pronesise mbi keto kuota.


Pranuesi i Dhurimit, pranon dhurimin nga ana e Dhuruesit, duke u bere zoterues i 45%(dyzetepesepersqind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, te zoteruara deri para kesaj kontrate nga Dhuruesi z. Julien Roche.

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhurimi, Dhuruesi humbet cdo te drejte pronesie mbi kapitalin themeltar te zoteruar prej tij ne shoqerine " ADA KONSTRUKSION " sh.p.k.


Te gjitha te drejttat e pronesise mbi kapitalin e zoteruar prej Dhuruesit, i kalojne Pranuesit te Dhurimit.

Kjo kontrate e hartuar ne 3 (tre ) kopje, njera nga te cilat mbetet ne Zyren e Noterise, dy te tjerat jane nga nje per secilen pale, pasi u lexohet paleve dhe gjendet e shkruar drejt dhe ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote, nenshkruhet prej tyre, dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.


**Dhuruesi**



**Pranuesi i Dhurimit**



NOTERE  
ELBA SINA



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 270 REP.  
NR. 37 KOL.



**KONTRATË DHURIMI KUOTASH**  
**(PER TRANSFERIMIN E KUOTAVE TE KAPITALIT THEMELTAR)**

Sot me date 20 .07.2005 ( dymije e pese ), perpara meje Noteres Elsa Sina, me seli ne Tirane, ne Rr. " Mihal Grameno ", u paraqiten personalisht palet e kesaj kontrate dhurimi kuotash kapitali, te cilat kerkuan hartimin e kontrates si me poshte:

**Palet e Kontrates:**

1. z. **Marsel SKENDAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Zagollit, i datelindjes 1949, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, ne Rr " Dervish Hima " Ada Tower, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Pasaporten me Nr.0012983, Ortak i Shoqerise " ADA KONSTRUKSION " Sh.p.k., person juridik i rregjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatës së Shkalles se Pare Tiranë, me vendimin nr. 26815, datë 13.10.2001  
( ne vijim " Dhuruesi " ); dhe

3. z. **Gjergj SKENDAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Marselit, i datelindjes 29.08.1981, lindur dhe banues ne Tiranë, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar nga Pasaporta. Nr. 21011411 ( ne vijim " Pranuesi i Dhurimit " );

**Baza Juridike e Kontrates**

Baza Juridike e kesaj kontrate eshte legjislacioni shqiptar, perkatesisht ligji Nr.7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ", neni 45 e vijim, dhe Kodi Civil Shqiptar, neni 761 e vijim .

**Objekti i Kontrates**

Objekt i kesaj Kontrate Dhurimi eshte dhurimi i kuotave te kapitalit themeltar, te cilat zoterohen nga Dhuruesi ne Shoqerine " ADA KONSTRUKSION " sh.p.k, person juridik i rregjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatës se Shkalles se Pare Tirane, me vendimin nr.26815, date 13.10.2001, me Ortake te saj, z.Julien Roche, zoterues i 45%( dyzet e peseperqind) te kuotave te kapitalit themeltar, me vlere 180.000 leke, z.Marsel Skendaj, zoterues i 45%( dyzet e peseperqind) te kuotave te kapitalit themeltar, me vlere 180.000 leke dhe z. Faruk Kaba, zoterues i 10%( dhjetepaqind) te kuotave te kapitalit themeltar, me vlere 40.000 leke, me seli ne ne Rr.Dervish Hima, " ADA TOWER ", Tirane.



Ortaku i Shoqerise ( Dhuruesi ), z. Marsel Skendaj, i dhuron kuotat e kapitalit themeltar qe zoteron ne Shoqeri, Pranuesit te Dhurimit, z.Gjergj Skendaj, duke i kaluar atij plotesisht te drejten e pronesise mbi kuotat perkatese te kapitalit themeltar te " ADA KONSTRUKSION"sh.p.k.

### **Kushtet e Kontrates**

Dhuruesi i dhuron Pranuesit te Dhurimit pa barre, pa kusht dhe pa shperblim, pjesen perkatese te kuotave te kapitalit themeltar, te zoteruar prej tij ne Shoqeri; konkretisht z. Marsel Skendaj dhuron 45%( dyzetepesepersqind) te kuotave te kapitalit themeltar, duke i kaluar Pranuesit te Dhurimit, z. Gjergj Skendaj, te drejten e pronesise mbi keto kuota.

Pranuesi i Dhurimit, pranon dhurimin nga ana e Dhuruesit, duke u bere zoterues i 45%(dyzetepesepersqind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "ADA KONSTRUKSION" sh.p.k.

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhurimi, Dhuruesi humbet cdo te drejte pronesie mbi kapitalin themeltar te zoteruar prej tij ne shoqerine " ADA KONSTRUKSION " sh.p.k.

Te gjitha te drejttat e pronesise mbi kapitalin e zoteruar prej Dhuruesit, i kalojne Pranuesit te Dhurimit, i cili behet zoterues i 45% ( dyzetepesepersqind ) te kuotave te Kapitalit te Shoqerise.

Kjo kontrate e hartuar ne 3 (tre ) kopje, njera nga te cilat mbetet ne Zyren e Noterise, dy te tjerat jane nga nje per secilen pale, pasi u lexohet paleve dhe gjendet e shkruar drejt dhe ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote, nenshkruhet prej tyre, dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.

**Dhuruesi**

Marsel Skendaj

**Pranuesi i Dhurimit**

Gjergj Skendaj

Bashkeshkruarja e dhuruesit  
Vera Skendaj